

Tiranë, më 13.09.2021

**Lënda: Informacion për mosrealizimin e kontratës së auditimit për Partinë e  
"Shkodra 2015"**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) **nr. 425, datë 12.07.2021**, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël të regjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partia **"Shkodra 2015"** për vitin kalendarik **2020**, të deklaruar në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës me nr **prot 6281 datë 23.08.2021**, me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve (KQZ-në), objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"*. Afati i përfundimit të procesit të auditimit është **23 Shtator 2021**.

Pasi arritem komunikimin zyrtar me kryetarin e Partise se **"Shkodra 2015"** z. Vullnet Elbasani morem deklarimet e kesaj partie qe nuk ka patur aktivitet dhe nuk ka perfituar fonde apo ka bere shpenzime per periudhen 01 janar 2020 -31 dhjetor 2021 .

**Partia "Shkodra 2015" sipas deklarimeve te bera nga kryetari i Kesaj Partie z. Vullnet Elbasni nuk ka dorezuar Pasqyra Financiare prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ).**

**Per kete arsye ne nuk mund te leshojme Opinion per Parine e "Shkodra 2015", pasi nuk kemi pasqyra financiare per vitin 2020 .**

Bashkengjitur ketij informacioni keni edhe Deklarimet e Partise se **"Shkodra 2015"** te firmosur e vulosur nga Kryetari i Partise se z. Vullnet Elbasani.

Faleminderit për mirkuptimin!

**Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)**

**Sherife HOXHA**



## Partia "Shkodra 2015"

Shkoder, më 06.09.2021

### Deklarimet e Partisë " Shkodra 2015"

Për audituesen Ligjore : Zj. Sherife Hoxha

Kjo letër e deklarimeve jepet në përgjigje të kërkeses tuaj date 29.08.2021 për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, nga partia "Shkodra 2015", autorizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Lidhur me kërkesen dhe informacionin e kërkuar nga ana juaj une, Vullnet Elbasani kryetar i kesaj partie, deklaroj me pergjegjesi te plote se Partia "Shkodra 2015 " gjate periudhes 1 Janar 2020-31 Dhjetor 2020:

- Nuk ka patur hyrje nga asnje burim të ardhurash, si kuotat e antarësise, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatore te huaj dhe vendas, hua, burime në natyre apo kompesime shpenzimesh.
- Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trasheguara nga viti 2019.
- Nuk ka realizuar asnje blerje mallrash e sherbime për llogari të partise nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi berë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur të punesuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huaperdorje.
- Nuk ka të hapur asnje llogari bankare ne bankat qe veprojne ne shqiperi dhe jashte saj.
- Nuk ka hapur NIPT fiskal në drejtorine tatimore rajonale.

Ne kushtet e mungeses së transaksioneve ekonomike dhe financiare nuk kemi dorezuar Pasqyrat Financiare me vlere zero që kerkohen nga KQZ-ja apo nga institucione te tjera shteterore për vitin 2020.

Konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

**Për Partinë "Shkodra 2015"**

Vullnet Elbasani



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular stamp. The stamp contains the text 'SHKODRA 2015' in a stylized font, with 'SHKODRA' on the top line and '2015' on the bottom line. The signature is written in a cursive style, starting from the left and extending across the top and right of the stamp.